

MBROJTËSI

Vëllimi III - Nr. 6 ... drejtësi për të gjithë



**SIGURIA
PËR
STATUS**



FUNDI i 2007-ës...

Së bashku me qytetarët e Kosovës kemi arritur afër momentit historik që ndërlidhet me të ardhmen politike të Kosovës. Deri tani jemi ballafaquar me sfidat nga më të ndryshme që do të shënohen në historikun e policisë së Kosovës. Me sakrificë dhe me përkushtim të vullnetshëm kemi dëshmuar se jemi në rrugë të drejtë të një shërbimi profesional, puna e të cilit është e mbështetur mbi parimet më të avancuara demokratike dhe të respektimit të të drejtave të njeriut.

Me vigjilencë kemi përcjellur tërë vitin zhvillimet politike në Kosovë pasi ato ndërlidhen drejt-përsëdrejti edhe me gjendjen e sigurisë në vend. Është bërë e ditur se pavarësisht se cili do të jetë rezultati i statusit final të Kosovës do të ketë palë të pakënaqura. Angazhimet dhe përgatitjet e policisë në muajt në vijim, por edhe të faktorëve tjerë kompetent të sigurisë, janë të adresuara në drejtim të menaxhimit sa më të mirë të situatave që mund të paraqiten në teren.

Gjatë punës në teren dhe kontakteve me gazetarë kam vërejtur edhe prezencën e shumë medie ndërkombëtare në Kosovë. Televizione të famshme e me renome ndërkombëtare si CNN, Euronews, BBC etj. kanë ardhur që nga afër të përcjellin situatën në Kosovë. Shumë prej tyre kanë shikuar me vëmendje se çfarë do të sjellë data e 10 dhjetorit duke pasur parasysh se është përfolur shumë se çka pas 10 dhjetorit!!!

Natyrisht që në momente të ndjeshme është shumë e rëndësishme që informatat që plasohen te qytetarët të jenë të shpejta dhe korrekte dhe që gazetarët të kenë mundësinë e marrjes së informatave nga burimet zyrtare. Vetëm me informacione zyrtare dhe të konfirmuara nga policia mund të luftohen dezinformatat dhe thashethemet e ndryshme.

Në situatën në të cilën ndodhet Kosova tani transparenca është me rëndësi jetike. Për t'u tejkaluar kjo sfidë me sukses, ditë më herët është organizuar një takim në mes zëdhënësve të policisë, zëdhënësve të Qeverisë, UNMIK-ut, MPB-së dhe disa institucioneve tjera. Kjo tregon rëndësinë që

është duke i kushtuar policia sferës së bashkëpunimit në menaxhimin e informatave të cilat duhet ose pritët të plasohen tek publiku.

Një takim tjetër i rëndësishëm që është mbajtur para disa ditëve është edhe takimi me tërë stafin komandues të SHPK-së dhe policisë së UNMIK-ut. Aty u diskutuan shumë pika të rëndësishme që ndërlidhen me zhvillimet politike për vendimin e statusit final të Kosovës, pastaj edhe për angazhimet konkrete të policisë gjatë muajve në vijim.

Në këtë numër që është i fundit për këtë vit, në faqet që janë të rezervuara rregullisht për MPB-në do të mund të lexoni për të arriturat dhe rezultatet gjatë tërë vitit. Zyrtarët e MPB-së gjatë vitit që po e lëmë pas kanë realizuar një varg takimesh me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë që i përkasin kryesisht fushës së sigurisë dhe në të gjitha këto takime e kanë potencuar çështjen e mungesës së kompetencave, të cilat e vështirësojnë bashkërendimin e punëve dhe aktiviteteve të MPB-së në raport me SHPK-në.

Gjatë vitit 2007, Ministria e Punëve të Brendshme ka arritur të bëj hartimin e Planit Strategjik 2007-2010 dhe Planit Operacional 2007-2008. Po ashtu gjatë këtij viti është bërë hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, në bazë të Planit të Veprimit dhe në bazë të standardeve të BE-së që veprohet në mënyrë të koordinuar nga ana e Policisë Kufitare, Shërbimit Doganor dhe Shërbimit Fito-sanitar.

Shumë aktivitete të ditëve të fundit janë përfshirë në temën kryesore "Siguria për Status" duke përfshirë këtu edhe deklarata të zyrtarëve të lartë nga jeta politike në Kosovë dhe bashkësia ndërkombëtare. Policia ka bërë përgatitje për skenarë të ndryshëm që mund të rezultojnë nga vendimi politik për statusin e Kosovës. Kjo do të jetë me siguri një sfidë e vështirë për t'u përballuar, por me përkushtimin që kanë oficerët e SHPK-së do të vazhdojnë edhe më tutje drejt përmbushjes së vizionit, së bashku me qytetarët e Kosovës duke ofruar një shërbim kompetent, profesional dhe të paanshëm.



Buletini informativ i policisë në Kosovë është botim i SHPK-së dhe policisë së UNMIK-ut.

Botues

Njësi i Redaksisë,
Zyra e Komisarit për Media,
SHP i Policisë, Prishtinë

Redaktor

ARBËR BEKA

VSAT: 2699

Tel.: 038 5080 1237

Mob.: 044 146 696

arber.beka@kosovopolic.com

arberbeka@gmail.com

protector@gmail.com

Fotograf / Disajner

HAKAN UGURLU

ÇAJUP KAJTAZI

VSAT: 2323

Mob.: 044 545 886

phototimor@yahoo.com

ugurlu@un.org

www.pbase.com/hugurlu

Asistentët e Redaktorit

DRIN GJONBALAJ

RENATA MARIJANAC



2



8



10



14



18



24

Profili i Oficerit

2 FLAMUR REXHAJ

4 MINISTRIA E PUNËVE TË BRENDSHME

Ministria e Brendshme dhe sukseset e saj gjatë vitit 2007

8 SHPK, PROFESIONALE DHE KRENARE

Mesazh nga Komisari i Policisë, Richard Monk

9 SHPK-ja ME VIZION DHE MISION TË PËRCAKTUAR

Mesazhi i Zv. Komisarit Sheremet Ahmeti

Tema Kryesore

10 SIGURIA PËR STATUS

14 ROLI I SHPK-SË NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR NË KOSOVË

Gjeneral Major Rrahman Sylejmani

16 SEKTORI I ARMËVE TË ZJARRIT SFIDAT DHE REZULTATET

Intervistë me rreshter Kadrush Koliqin

18 NJERËZIT SIKUR JU NË SHËRBIMIN TUAJ

Institucionet e sigurisë në Kosovë komunikojnë me publikun

20 ATY KU REZULTATET E PUNËS NUK MUNGONJË

DSSHPK-ja festoi 6 vjetorin e themelimit

20 SOLIDARIZIMI ËSHTË ÇELËSI KRYESOR PËR T'I TEJKALUAR SFIDAT

SSHPK-ja merr pjesë në Kongresin e Konfederatave të Sindikatave të Policisë së Evropës - Eurocop

Lajmet nga rajonet

22 NAIM MALAZEZI

Kampion i Atletikës Kosovare

23 REZULTATET E ARRITURA NGRITIN IMAZHIN E SHPK-SË

Intervistë me shefin e hetimeve - toger Muhamet Lama

Foto lajme

24 ZGJEDHJET 2007

PIKË SHITESË :

Mendimet, komentet, këndvështrimet e shprehura ose të përfshira në përmbajtje të këtij botimi nuk paraqesin medeomos politikat ose vështrimet zyrtare të UNMIK-ut dhe SHPK-së.

MENDJA E SHËNDOSHË NË TRUP TË SHËNDOSHË

FLAMUR REXHAJ

Flamur Rexhaj u lind me datën 24.06.1975 në Pejë. Shërbimit Policor iu bashkëngjit në dhjetor të vitit 2000 në gjeneratën e 11-të.

Ai ka përfunduar shkollën e mesme Teknike në Pejë në drejtimin e Elektroteknikës ku ishte njëri prej nxënësve më të dalluar të asaj shkolle.

Pas përfundimit të trajnimit bazik në Akademinë Policore në Vushtrri filloi detyrën në Stacionin Policor të Pejës. Oficeri Rexhaj punoi një kohë në sektorin e patrullës dhe në njësinë e trafikut ku tregoi rezultate të kënaqshme.

Në vitin 2002 iu bashkëngjit Njësitit Special të atëhershëm "Krimet Rrugore" për t'u transferuar kjo njësi në njësinë Operativ Mbështetës ka punuar deri në vitin 2006.

Oficeri Rexhaj ka mbaruar me sukses edhe shumë trajnime ku (14 sosh) në fusha të ndryshme Policore. Momentalisht është duke punuar në Stacionin Policor të Pejës në njësinë EKO - Njësi kundër krimeve Ekologjike ku është duke dhënë rezultate të shkëlqyeshme.

Përveç detyrave në polici ju merreni edhe me aktivitete sportive. Sa është e rëndësishme përgatitja fizike për oficerët policor?

Oficeri Rexhaj: Mendoj se përgatitja fizike është e rëndësishme në çdo polici në botë. Për shkak të specifikave të detyrave të përditshme që ne i kryejmë në polici, duhet të jemi në gjendje të mirë fizike krahas aftësive tjera të nevojshme për secilin oficer.

Ju punoni si pjesëtarë i SHPK-së por njëherësh merreni me Sportin e Bodybuilding-ut (Sporti për ndërtimin e trupit) Pse zgjidhët këtë lloj të sportit?

Oficeri Rexhaj: Mendoj se Bodybuilding-u është një sport i mirë dhe i shëndetshëm. Ky sport më ndihmon shumë edhe në aspektin profesional - Kur jam i përgatitur në aspektin fizik dhe psikik puna policore kryhet me lehtësi – Mendja e shëndoshë në trup të shëndoshë.



Qe sa kohë merreni me Bodybuilding ?

Oficeri Rexhaj: Unë me sportin e Bodybuilding-ut aktiv merrem që nga viti 1995. Kjo ishte vetëm vazhdimësi e traditës sime familjare duke pasur parasysh se edhe vëllezërit e mi më të moshuar se unë janë marrë me këtë lloj të sportit dhe kanë arritur rezultate të kënaqshme.

A keni marr pjesë në gara vendore dhe ndërkombëtare dhe nëse po cilat janë ato gara ?

Oficeri Rexhaj: Unë edhe pse kam filluar të merrem me këtë sport që nga viti



1995 në gara kam filluar të marr pjesë më vonë. Që nga viti 2004 kam pjesë rregullisht në kampionatin e Kosovës, ndërsa sa i përket garave ndërkombëtare kam qenë pjesëmarrës në Kampionatin Evropian në Greqi që është mbajtur në vitin 2006 në Athinë.

Cilat janë rezultatet më të mira në karrierën tuaj në gara vendore dhe ato ndërkombëtare ?

Oficeri Rexhaj: Në vitin 2004, 2005, 2006 dhe në 2007-ën jam shpallur kampion absolut i Kosovës ndërsa në vitin 2004 dhe në vitin 2007 jam shpallur kampion absolut Mbarëkombëtar në Shqipëri. Sa i përket garave ndërkombëtare në vitin 2006 në Kampionatin Evropian në Athinë kam arritur të kualifikohem në vendin e IV-të në Kategori të rendë ku kishte një konkurrencë tejet të fortë. Në arritjen e këtyre sukseseve më ka ndihmuar

shumë edhe përkrahja e kolegëve në punë që nuk mungon asnjëherë.



Cilat janë ambiciet e juaja në sportin e Bodybuilding-ut në të ardhmen ?

Oficeri Rexhaj: Unë e kam nënshkruar me reprezentacionin e Shqipërisë një kontratë ku do ta përfaqësoj

Shqipërinë në kampionatin Evropian dhe Botëror të cili kampionat pritet të mbahet në pjesën e parë të vitit 2008 dhe pres që të korr rezultate të mira .

Në të ardhmen kam në plan ta hartoj një projekt propozim që Stacioni policor i Pejës i cili stacion ka hapësirë të mjaftueshme, të pajiset me mjete të ndryshme për ushtrimin e sporteve të ndryshme, dhe aty do të krijonim një hapësirë (Sallë) ku do të ushtronin Policët në vazhdimësi në mënyrë që të mbahet kontinuiteti i aftësive Psiko – Motorike të secilit oficer.

Intervistoi: Zyra për Informim e rajonit të Pejës

**Bajram MJEKU**

MINISTRIA E BRENDSHME DHE SUKSESET E SAJ GJATË VITIT 2007

Duke patur parasysh se Ministria e Punëve të Brendshme është themeluar në dhjetor të vitit 2005, kjo Ministri përkundër pengesave dhe mungesës së kompetencave, ka shënuar një varg suksesesh që nga themelimi i saj

Vitin e kaluar, sfidë e Ministrisë së Punëve të Brendshme ishte kompletimi i stafit të saj, ndërkohë që gjatë këtij viti MPB është angazhuar në bartjen e kompetencave që mbeten ende për t'u dëshiruar. MPB veç aktiviteteve të tjera, gjatë këtij viti është angazhuar mjaft edhe në fushën e legjislacionit dhe në segmente të rëndësishme të sigurisë në Kosovë. Gjatë vitit që po e lëmë pas, ministri i Punëve të Brendshme, z. Blerim Kuçi ka realizuar një varg takimesh me ekspertë vendorë e ndërkombëtarë që i përkasin kryesisht fushës së sigurisë dhe në të gjitha këto takime e ka potencuar çështjen e mungesës së kompetencave, të cilat e vështirësojnë bashkërendimin e punëve dhe aktiviteteve të MPB-së në raport me SHPK-në



Hartimi i Planit Strategjik 2007-2010 dhe Plani Operacional 2007-2008

Gjatë vitit 2007, Ministria e Punëve të Brendshme ka arritur të bëjë hartimin e Planit Strategjik 2007-2010 dhe Planit Operacional 2007-2008. Po ashtu gjatë këtij viti është bërë hartimi dhe miratimi i Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Kufijve, në bazë të Planit të Veprimit dhe në bazë të standardeve të BE-së që veprohet në mënyrë të koordinuar nga ana e Policisë Kufitare, Shërbimit Doganor dhe Shërbimit Fito-sanitar. Njëri ndër sukseset që vlenë të përmendet gjatë vitit 2007 ishte edhe menaxhimi pas shpërthimit të mijëra vatrave të zjarreve gjatë muajve korrik dhe gusht të këtij viti, kur ministri i Punëve të Brendshme, z. Blerim Kuçi ishte kryetar i Këshillit Ndërmëtor për Menaxhim të Emergjencave në kuadër të Qeverisë së Kosovës. Ashtu si faktorët vendorë, edhe ata ndërkombëtarë kanë vlerësuar se Ministria e Punëve të Brendshme e ka tejkaluar me sukses sfidën e shpërthimit të mijëra zjarreve në tërë territorin e Kosovës.

Marrëveshja për pakon e mirëqenies sociale për pjesëtarët e SHPK-së

Po ashtu gjatë këtij viti Ministria e Punëve të Brendshme e ka përgatitur edhe strategjinë për riintegrimin e personave të riatdhesuar, pastaj ka punuar në hartimin e Politikave të Ripranimit, arritjen e marrëveshjes me Ministrinë e Financave për Pakon e Mirëqenies Sociale për pjesëtarët e SHPK-në, pastaj nënshkrimin e Memorandumit të Mirëkuptimit në mes MPB-së, Ministrisë së Drejtësisë, Këshillit Gjyqësor të Kosovës, Prokurorisë Publike të Kosovës, Departamentit të Drejtësisë, Komisionarit të Policisë, Komisionarit të Ndihmës Juridike dhe Odës së Avokatëve të Kosovës për formimin e Këshillit Koordinues për Sundim të Ligjit. Po ashtu gjatë vitit 2007 është realizuar edhe projekti i përshpejtimit të procedurave të pajisjes me dokumente personale për pjesëtarët e diasporës kosovare dhe hartimin e ligjeve për funksionimin e

MPB-së. Gjatë këtij viti është ngritur edhe niveli i bashkëpunimit me Policinë e UNMIK-ut dhe SHPK-në, si dhe rezultati në ndryshimin e strukturës organizative të SHPK-së me qëllim të funksionimit më të mirë të saj.

Përpjekjet e MPB-së në shtrirjen e mandatit në Veriun e Kosovës

Si rezultat i prekshëm gjatë vitit 2007 mbeten përpjekjet e MPB-së në shtrirjen e mandatit në pjesën Veriore të Kosovës. Gjatë këtij viti, ministri i Punëve të Brendshme, Blerim Kuçi, zëvendëskomisari i SHPK-së, gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti dhe bashkëpunëtorët e tyre e kanë vizituar Veriun e Mitrovicës ku janë njohur për së afërmi me punët, aktivitetet, por edhe me sfidat e Shërbimit Policor të Kosovës për të shtrirë fushën e sigurisë edhe në këtë pjesë të territorit të Kosovës.

Po kështu gjatë këtij viti janë bërë përpjekje për aplikim në Byronë Evropiane për Polisa të Sigurimit të Auto-Përgjegjësi (që është në proces), pastaj projekti për ngritjen e perceptimit publik në SHPK (fushatë mediale dhe aktivitete në terren që fillon më 1 nëntor dhe përfundon më 26 dhjetor të këtij viti, pastaj puna intensive në hartimin e procedurave për transferin e kompetencave, ku MPB bashkëkryeson me Grupin Punues për Transferin e Kompetencave në Sundimin e Ligjit), pastaj bashkëpunimi më i ngushtë me organizatat ndërkombëtare në Kosovë dhe jashtë Kosovës, si dhe me përfaqësues diplomatike në Kosovë. Gjatë këtij viti është bërë edhe studimi i fizibilitetit për Qendrën e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim në Vushtrri, ku kanë filluar punët në projektin e ri për këtë Qendër dhe përngjitjen e saj në nivel të institucionit akademiko-arsimor. Gjithashtu gjatë këtij viti është bërë edhe bartja e kompetencave të Gjendjes Civile nga MSHP-ja në MPB, si dhe është bërë transferi i punëtorëve që kryejnë shërbime për MPB-në, që ishin nën mbikëqyrjen e komunave. Po ashtu gjatë këtij viti janë hapur disa qendra

për regjistrimin e automjeteve në komuna të ndryshme të Kosovës.

Legjislacioni, njëri nga segmentet më të suksesshme

Gjatë këtij viti janë miratuar disa ligje nga Qeveria dhe Parlamenti i Kosovës, të cilët janë sponsorizuar nga Ministria e Punëve të Brendshme. Kështu, Ligji për Regjistrat e Gjendjes Civile i nënshkruar nga PSSP-ja në vitin 2005, është plotësuar në vitin 2007 dhe është miratuar nga Parlamenti i Kosovës. Ligji për Mbrojtje nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë Tjera është nënshkruar nga PSSP-ja më 15 janar të vitit 2007. Ligji për Numrin Personal është miratuar këtë vit nga Kuvendi i Kosovës. Ligji për Emrin Personal është miratuar po ashtu këtë vit në Kuvendin e Kosovës, si dhe Ligji për Letërnjoftimin është miratuar në Kuvendin e Kosovës gjatë këtij viti. Po ashtu gjatë këtij viti Kuvendi i Kosovës e ka miratuar edhe Ligjin për Vendbanim dhe Vendqëndrim, ndërsa është miratuar në Kuvend edhe Projektligji për Statusin Civil i sponsorizuar nga MSHP-ja. Është miratuar po ashtu edhe Ligji për Dokumentet e Udhëtimit, ndërsa nga Qeveria e Kosovës gjatë vitit 2007 janë miratuar Projektligji për të Huajt, Projektligji për Shtetësinë, Projektligji për Kufirin, Projektligji për Azil, Projektligji për Eksplozivët dhe Projektligji për Policinë. Vlen të theksohet se për Projektligjin për Armën është përfunduar drafti fillestar dhe së shpejti do të dërgohet në Qeveri për formimin e Grupit qeveritar dhe për hartimin e draftit përfundimtar. Po ashtu në fazën e hartimit të draftit përfundimtar është edhe Projektligji për Siguri Private me vendim të Sekretarit të Përhershëm të ZKM-së. Është përfunduar drafti fillestar edhe i Projektligjit për Inspektoratin Policor dhe i njëjti është dërguar në Qeveri për formimin e grupit punues qeveritar për hartimin e draftit përfundimtar.

(Autori është drejtor i Zyrës për Marrëdhënie me Publikun në Ministrinë e Punëve të Brendshme).

SHPK, PROFESIONALE DHE KRENARE

**Mesazh nga
Komisari i Policisë,
RICHARD MONK**

Viti 2007 ka qenë i një rëndësie të madhe për SHPK-në. Ne kemi marre disa hapa të mëdhenj përpara, duke u ballafaquar me disa sfida të forta dhe tani në fund të vitit SHPK është afër synimit final të bëhet agjencia e vetme për zbatimin e ligjit në Kosovë.

Gjatë tërë vitit pjesëtarët e SHPK-së janë thirrur të merren me rastet e prishjes së rendit publik dhe çrregullime vendore, protesta politike, sigurim të zgjedhjeve, raporte të vjedhjes së pasurisë dhe dëmtime kriminale, lëndime në aksidente trafiku dhe fatalitete, kontrabandë, korrupsion nga zyrtarët, kërcënime, dhunë - disa të motivuara etnikisht, sulme seksuale, plaçkitje, tentim vrasje dhe vrasje, dhe u është dashur të ballafaqohen me kriminel të gatshëm për të mos kursyer asgjë që ti shmangen kapjes. Në këtë drejtim, oficerët e policisë janë sharë, sulmuar, është shtënë në ta dhe po ashtu janë vrarë. Ata janë ndeshur me njerëz në momentet e vdekjes, kanë qenë dëshmitar të veprimeve të jashtëzakonshme të kurajës dhe kanë parë nga dora e parë ndikimin keqdashës të shprehur në jetët e njerëzve. Sidoqoftë, përkundër pagave të ulëta, të ardhurave minimale, dhe nevojës për pajisje më kualitative, pjesëtarët e SHPK-së kanë arritur rezultate mbresëlënëse dhe unë sinjerisht lavdëroj secilin për këmbënguljen dhe mbështetjen e njëri tjetrit.

Nga ekspozimi i shumë çështjeve operative ne kemi nxjerrë mësim të vlefshme. Në shkurt, dy persona janë vrarë gjatë trazirave të cilat janë përcjell me demonstrata nga Vetëvendosja. Ndonëse SHPK-ja nuk është për tu fajësuar, shkalla e tragjedisë na ka shtyrë të shikojmë me sy kritik në ndryshimet që duhet të inkuorohen në komandën tonë dhe sistemin e kontrollit si dhe në procedurat tona operative dhe planifikimit.

Njëllon, rast tragjik ishte humbja e jetës së gjashtë policëve gjatë këtij viti, përfshirë këtu edhe vrasjen në linjë të detyrës të oficerëve Avni Kosumi dhe Triumf Riza. Tronditja dhe pikëllimi për vdekjen e tyre dhe hidhërimi i ndier nga familjet e tyre dhe kolegët ishte i thellë dhe nuk ka gjasë të zbehet ndonjëherë. Vrasësi i Policit Kosumi ende nuk është kapur, por i dyshuari për vrasjen e policit Riza është kapur. Menjëherë pas vdekjes së tij, qytetarët e Kosovës kanë marshuar në një protestë të

qetë në kujtimin e tij dhe protestuan kundër krimit të organizuar. Ishte aq e jashtëzakonshme shprehja e mbështetjes për policinë e Kosovës, sa që xhirimet përshkuan mbarë botën.

Në fillim të vitit, 68 % të njësisve policore të SHPK-se u janë bartur kompetencat. Deri në fund të vitit do të arrij në 90%. Aktualisht, një polic i SHPK-së është Shef i Stafit në vend të një ndërkombëtar dhe një polic tjetër i SHPK-së përfaqëson policinë në konferencat javore për shtyp të UNMIK-ut. Po ashtu me tranzicion vjen edhe përgjegjësia operative për menaxhimin e reagimit policor gjatë demonstratave ose protestave, pasi që të gjitha kanë kaluar pa dhunë dhe prishje të rendit. Këta hapa të rëndësishëm dhe të suksesshëm japin sinjal të dukshëm tek agjencitë jashtë SHPK-së, posaçërisht tek Unioni Evropian që Shërbimi është në një shkallë të avancuar të zhvillimit.

E një rëndësie vendimtare është fakti se ne tani kemi një vizion të përbashkët për të ardhmen, në krye me bordin ekzekutiv të organizatës përgjegjëse për politikën e reja, ndryshimet në strukturën organizative dhe sisteme të reja që të arrihet kjo. Që të jemi të suksesshëm, ne po ashtu kemi nevojë të kuptojmë më mirë kërkesat aktuale dhe të ardhme të policimit në linjë e veprimit dhe zhvillimit të strategjive, aftësive, trajnimit dhe burimet që ti arrijmë ato. Identifikimi i nevojave të gjera të policimit është në veprim e sipër. Duke ofruar më shumë trajnime për të dy palët, Policinë dhe Personelin Civil dhe zhvillimin e karrierave tyre individuale do të jetë roli primar në shtyllën e posa formuar të burimeve njerëzore.

Derisa po e shkruaj këtë, ne jemi duke pritur një moment historik për të ardhmen politike të Kosovës, dhe po planifikojmë rezultatet e mundshme. Çfarëdo që të jenë përfundimet, asgjë që ne veprojmë nuk do favorizoj ndonjë marrëveshje politike në asnjë mënyrë. Roli jonë si polic është gjithnjë të mbajmë rendin dhe zbatimin e ligjit, paanësisht dhe pa frikë ose favorizim. Kjo do të jetë një sfidë e vështirë por po ashtu do të jetë një mundësi që të fitohet më shumë respekt në sytë e qytetarëve të Kosovës dhe tu dëshmojmë kolegëve tonë ndërkombëtar se ne jemi krenarë dhe shërbim policor profesional.

Ju uroj të gjithë juve dhe familjeve tuaja dëshirat më të ngrohta për vitin 2008.



SHPK-ja ME VIZION DHE MISION TË PËRCAKTUAR

Të nderuar kolegë të SHPK-së ne po lëmë pas një vit të punës, sukseseve dhe sfidave të mëdha si dhe të pritjeve për të gjithë. Unë gjatë kësaj periudhë jam ndier krenarë me institucionin të cilit i shërbej falë angazhimit të gjithë personelit të SHPK-së. Falënderimi për sukseset tona shkojnë edhe për policinë e UNMIK-ut e cila vazhdimisht e ka përkrahur duke u bërë pjesë aktive në zhvillimin tonë të përgjithshëm.

Shërbimi Policor i Kosovës punën e tij e ka mbështetur mbi parimet më të avancuara demokratike, standardeve ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe sundimin e ligjit. Falë punës sonë mbi këtë bazë ne kemi arritur që për këto tetë vite të arrijmë një shkallë të zhvillimit, konsolidimit dhe tranzicionit në drejtim të marrjes së përgjegjësisë shtesë.

Në vazhden e sukseseve të saja SHPK-ja sot ka një vizion dhe mision të përcaktuar për tri vitet e ardhshme të përfshira këto në një plan strategjik.

Në rend të parë për SHPK-në është obligim që vazhdimisht ti përkujtojë djemtë dhe bijat e saja më të mirë të cilët nuk kursyen as jetën e tyre për të qenë në shërbim të misionit që ka policia dhe në shërbim të qytetarëve. Pikëlluese dhe shumë e dhembshme gjatë këtij viti ka qenë humbja e dy kolegëve në krye të detyrës: Avni Kosumi dhe Triumf Riza. Kjo edhe njëherë vërtetoi se sa i vështirë është profesioni i policit.

Në përgjithësi gjatë këtij viti SHPK-ja është duke kaluar në një fazë të rëndësishme të zhvillimit të saj. Në këtë kohë para nesh shtrohen shumë detyra dhe sfida që presim të ballafaqohemi në fazën e përcaktimit final të statusit të Kosovës.

E rëndësishme për ne është përcaktimi i platformës dhe veprimtarisë së sonë identifikimi i fushave aktuale që janë prioritet për SHPK-në në mënyrë që të arrijmë të përmirësojmë cilësinë e shërbimeve tona, identifikimin e mangësive dhe dobësive tona si dhe mundësitë e organizatës sonë në përgjithësi.

Qëllimi kryesor i Shërbimit Policor të Kosovës është që të ruaj paqen dhe të zbatoj ligjin, ruaj rendin e qetësinë në Kosovë përmes vendosjes së një shërbimi efektiv dhe efikas policor që është i dedikuar në parimet e policisë demokratike. SHPK-ja ka



MESAZHI I Zv. KOMISARIT SHEREMET AHMETI

për qëllim që të ofrojë një ambient të sigurt për qytetarët si dhe rrisë besimin e qytetarëve në polici sepse shkalla e suksesit tonë është niveli i besimit të qytetarëve. Këtë qëllim përpiqemi ta arrijmë përmes mbajtjes së diversitetit etnik dhe gjinor në shikimin afatgjatë si synim i SHPK-së në njërin anë duke mos sakrifikuar minimumin e standardeve apo kritereve të përcaktuara në anën tjetër.

Strategjia jonë ka për qëllim të ndikojë në krijimin e një Shërbimi Policor të shëndoshë dhe kredibil qëllimi i së cilës është rritja e kualitetit të shërbimeve tona, efikasitet më të lartë, ngritja e performancës në të gjitha fushat, krijimi i një policie me një strukturë koherente dhe të qëndrueshme, transparente, respektimin e standardeve më të larta të të drejtave të njeriut në harmoni me standardet e të drejtave të njeriut dhe parimet e përgjegjësisë ndaj qytetarit si dhe në pajtim me parimet e policimit demokratik.

Përpjekjet tona gjatë kësaj kohe janë fokusuar në ndërtimin e një politike të vendimmarrjes racionale dhe të integruar sa i përket politikave të SHPK-së, si rezultat i kësaj është themeluar Bordi Ekzekutiv i SHPK-së si niveli më i lartë vendimmarrës, janë arritur edhe rezultate tjera si: hartimi i kodit të ri të Etikës në pajtim me Kodin Evropian të Etikës Policore, është hartuar plani i parë Strategjik për vitin 2008-2010, është bërë hapja e disa nënstacioneve policore të cilat kanë për qëllim ta ofrojnë SHPK-në më afër komunitetit, këtë vit janë

planifikuar dhe menaxhuar nga vet SHPK-ja planet operative për protesta të cilat në fund kanë rezultuar me sukses, strategjia e inteligjencës kriminale, është kontribuar mjaftë në rregullimin ligjor të fushës së policisë, ngritja e mirqenjes së zyrtarëve policor etj. Si përmbledhje e të gjitha rezultateve lufta kundër krimit ka dhënë rezultate të shumë të mira.

Të gjitha këto suksese të përgjithshme por edhe shumë të tjera që nuk janë përmendur më lartë janë rezultat i angazhimit dhe përkushtimit të të gjithë personelit të policisë së Kosovës duke filluar nga niveli bazë e deri tek ai më i lartë. Falënderimet e mia të veçanta shkojnë në drejtim të zyrtarëve policor të nivelit të parë (policët e patrullës, trafikut, hetuesit etj.) të cilët në mënyrë të drejtpërdrejtë kanë zbatuar ligjin dhe kanë realizuar objektivat e SHPK-së.

Unë i siguroj të gjithë personelin e SHPK-së se Stafi i Lartë i SHPK-së do të bëjë vazhdimisht përpjekje maksimale për të organizuar dhe planifikuar veprimtarinë policore, do të përmirësojë vazhdimisht kushtet e punës dhe do të kujdeset pandërprerë për mirëqenien e të gjithë të punësuarve në mënyrë që të jemi shembull më i mirë jo vetëm në Kosovë por edhe më gjerë, e unë kam besimin e plotë se këtë do ta arrijmë duke ju falënderuar djemve dhe vajzave që ka SHPK-ja.

Synimet tona dhe sfidat kryesore për të ardhmen do të jenë: marrja e përgjegjësisë nga policia e UNMIK-ut, Krijimi i partneritetit me strukturat e Bashkimit Evropian, lufta kundër krimit e në veçanti kundër krimit të organizuar, ndërtimi dhe ngritja e partneritetit me komunitet, riorganizimi funksional i SHPK-së duke ia përshtatur kohës dhe ndryshimeve, ndërtimi i filozofisë së ushtrimit të veprimtarisë policore në mënyrë pro-aktive, ndërtimi i vazhdueshëm i kapaciteteve të SHPK-së përmes përgatitjes së resurseve humane që kemi, forcimi i bashkëpunimit me agjencitë tjera të zbatimit të ligjit si: doganat, shërbimin korrektues, gjykatat, prokurorinë etj., integrimi në familjen e organizatave policore demokratike etj.

Me përgëzimin për të arriturat gjatë vitit 2007 ju falënderoj dhe ju dëshiroj suksese edhe më të mëdha për vitin 2008.

SIGURIA PËR STATUS

Derisa pritet që vendimi për statusin final të merret në mënyrë të koordinuar me bashkësinë ndërkombëtare dhe institucionet vendore, policia vazhdon të përballlet me sfidat e sigurisë në këtë kohë të rëndësishme për Kosovën. Sipas raporteve të përgatitura nga policia dhe agjencione tjera gjendja e sigurisë së përgjithshme në Kosovë është e qetë dhe stabile.

Sidoqoftë, për shkak të rrethanave politike nëpër të cilat është duke kaluar Kosova, ajo vazhdon të jetë e ndryshme si pasojë e faktorëve të ndryshëm që kanë të bëjnë me procesin politik që është duke u zhvilluar në Kosovë.

Pas "pakos" së Ahtisaarit bisedimet për statusin final të Kosovës vazhduan edhe për një periudhë shtesë 120 ditëshe (deri më 10 dhjetor 2007) të udhëhequra nga Treshja

ndërmjetësuese e Grupit të Kontaktit. As këto bisedime ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit nuk dhanë ndonjë rezultat konkret.

Grupi i kontaktit (SHBA, Rusia, Britania, Franca, Gjermania dhe Italia) insiston në parimet udhëzuese: që të mos ketë kthim të Kosovës në situatën e para 1999-ës; që të mos ketë ndarje të vendit; që të mos ketë bashkim të Kosovës me ndonjë shtet tjetër; dhe që statusi përfundimtar të





jetë i pranueshëm për shumicën e popullit të Kosovës me respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të minoriteteve.

Në raundin e fundit të bisedimeve të mbajtur në Badem të Austrisë, Presidenti Sejdiu bëri të ditur se Institucionet e Kosovës pas 10 dhjetorit nuk dëshirojnë më bisedime të mëtejme për statusin e Kosovës:

“Ne emër të Ekipit të Unitetit, në emër të institucioneve dhe të popullit të Kosovës, shpreh qëndrimin tonë të përbashkët se ne nuk jemi të gatshëm të pranojmë procese të tjera të negociatave, përkatësisht të bisedimeve. Arsyet janë të qarta. Çdo vazhdim i mëtejshëm nuk sjell asnjë rezultat dhe në të njëjtën kohë paraqet rrezik potencial për të ardhmen dhe perspektivën e Kosovës dhe të qytetarëve të saj”- theksoi Presidenti Sejdiu në fjalimin e tij të mbajtur në raundin e fundit të bisedimeve në Badem të Austrisë. Ai theksoi se “Ekipi i Unitetit kishte pranuar këtë kohë të angazhimeve shtesë me qëllimet më të mira për të qenë pjesë dhe kontribuues në një proces të tillë me qëllim shumë serioz dhe të hapur të ri-shprehim

edhe një herë argumentet tona pse Kosova duhet të jetë e pavarur, duke shtresuar pakështu se do të merret dhe pranohet qasja jonë për marrëdhëniet e ardhshme të mira midis dy vendeve.”

Në ndërkohë Treshja e grupit të Kontaktit vizitoi Prishtinën dhe

Beogradin për të diskutuar me të dyja palët projekt-raportin i cili ju dorëzua Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara - Ban Ki Moon.

Përfaqësuesi i Shteteve të Bashkuara, Bashkimit Evropian dhe Rusisë, që për mëse katër muaj drejtuan



bisedimet shitesë për statusin e Kosovës, deklaruan për media se raporti nuk do të përmbajë asnjë propozim për zgjidhjen e statusit, por do të jetë një përshkrim i rrjedhës së bisedimeve.

Këto bisedime dështuan të arrijnë ndonjë marrëveshje mes të dyja palëve për shkak të qëndrimeve krejtësisht të kundërta mes Prishtinës dhe Beogradit.

Në anën tjetër policia vazhdon me angazhimet e tyre për një ambient të qetë dhe të sigurt në Kosovë. Që nga dhjetori i vitit 2005 policia miratoi planin operativ "Siguria e Rreptë" që ka shtrirje në tërë Kosovën. Qëllimi i këtij plani është përmirësimi i situatës së sigurisë për të siguruar një ambient të sigurt për komunitetet minoritare dhe për të gjithë qytetarët e Kosovës, për të zbatuar kështu në mënyrë më të rreptë, në sens proaktiv, veprimet policore ndaj kriminelëve të dyshuar përgjatë gjithë vendit.

"Siguria e Rreptë" është një operacion policor i intensitetit të lartë që ka për qëllim përforsimin e dukshmërisë së policisë për të arritur një ambient më të sigurt, duke vepruar në mënyrë proaktive në rrugë me patrullime në këmbë dhe veturë,

kontrollime të rastit dhe statike të veturave dhe patrullime sektori. Në esencë është një operacion afatgjatë i rritjes së sigurisë që shkallëzon aktivitetet policore nga rutina deri tek dukshmëria policore e profilit të lartë 24 orësh përgjatë gjithë vendit. Në anë tjetër SHPK-ja dhe policia e UNMIK-ut janë duke vazhduar në realizimin dhe përgatitjen edhe të planeve tjera operative për një menaxhim sa më të mirë të sigurt të situatës së sigurisë në fazën më të ndjeshme për Kosovën.



Komisari i policisë Richard Monk së bashku me zv. Komisarin Sheremet Ahmeti dhe eprorë të tjerë të lartë kishin ftuar stafin komandues të policisë duke përfshirë këtu komandantët e nënstacioneve, stacioneve policore dhe ata të rajoneve, si dhe

udhëheqës të departamenteve të ndryshme për t'ju dhënë mesazhin e qartë për punët dhe angazhimet që e presin policinë në javët dhe muajt në vijim.

Në këtë takim që u mbajt më 9 dhjetor në "sallën e kinemasë" të ndërtesës së UNMIK-ut, u diskutuan shumë pika të rëndësishme që ndërlidhen edhe me zhvillimet politike për vendimin për statusin final të Kosovës si dhe për urdhërin operativ "Statusi" i cili saktëson angazhimet konkrete të policisë gjatë muajve në vijim – para definimit të statusit final dhe pas statusit. Mbi 300 zyrtarë policor të mbledhur aty dëgjuan me vëmendje këshillat dhe udhëzimet rreth këtij plani.

Gjeneral major Reshat Maliqi, asistenti i Zv. Komisarit për Operativë duke folur për urdhrin operativ "Statusi" theksoi se policia do të vazhdojë angazhimet për identifikimin e "vatrave të mundshme të nxehta" dhe për të ngritur ndjenjën e sigurisë:

"Ne do të vazhdojmë që të vëzhgojmë me vëmendje situatën që po zhvillohet në teren. Ditëve dhe javëve në fillim do të ketë një mbulim shumë më të mirë operativ të



terrenit e në kuadër të kësaj do të ketë edhe më shumë oficerë duke patrulluar në këmbë. Në bashkëpunim edhe me agjencionet tjera të sigurisë në Kosovë, nuk do të lejojmë që të përsëriten situata si ato të Marsit të vitit 2004. SHPK-ja do të dëshmojë përkushtimin profesional duke ofruar siguri për të gjithë qytetarët"- theksoi gjeneral-major Reshat Maliqi.

Në kuadër të këtyre planeve dhe detyrave të rëndësishme që shtrohen para policisë, vihet në pah edhe bashkëpunimi shumë i nevojshëm edhe agjencionet tjera përgjegjëse për siguri..

Policia mban takime të rregullta me KFOR-in të cilët janë duke u angazhuar për një ambient të qetë në Kosovë. Në një vizitë që bëri Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s në Kosovë - Jaap De Hoop Scheffer theksoi se trupat e NATO-s në Kosovë do të ruajnë paqen dhe qetësinë në Kosovë:

"Trupat e NATO-s do të bëjnë atë që është e domosdoshme që të ruajnë paqen dhe qetësinë në Kosovë dhe të mbrojnë banorët e saj pavarësisht përkatësisë së tyre etnike." – theksoi Scheffer. Ai tërhoqi vërejtjen se çdo kush që mendon të zgjidhë problemet me dhunë do të marrë përgjigjen e trupave të KFOR-it. Ai tha se Kosova ndodhet në një fazë të ndjeshme të zgjidhjes së statusit, prandaj të gjithë duhet të jenë të matur në veprimet e tyre.

"Është shumë e rëndësishme për të gjithë që ta kuptojnë se dhuna nuk është kurrë një opsion dhe dhuna nuk zgjidh kurrë problemet politike,



prandaj dhuna nuk do të tolerohet. Për këtë arsye në Kosovë ndodhen trupat e KFOR-it dhe e përsëris se çdo kush që mendon të zgjidhë problemet me dhunë e ka gabim," tha Jaap De Hoop Scheffer pas disa takimeve që zhvilloi me përfaqësuesit ndërkombëtarë në Kosovë, ata civilë e ushtarakë dhe udhëheqësit e institucioneve të Kosovës. Edhe SHPK-ja ka bërë përgatitjet e nevojshme për skenarë të ndryshëm që mund të rezultojnë nga vendimi politik për zgjidhjen e statusit të Kosovës. Në një intervistë për Mbrojtësin, gjeneral nënkolonel Sheremet Ahmeti shprehet se SHPK-ja është e gatshme që të menaxhojë situatën e krijuar me përkrahjen e qytetarëve kosovar:

"Ne me angazhimet, planifikimet e vazhdueshme dhe të nevojshme në bazë të rrethanave të ndryshme eventuale që paraqiten për shkak të situatës në Kosovë, kemi bërë që edhe në kushtet eventuale të pakënaqësisë së qytetarëve të menaxhojmë situatën. Jam shumë i sigurt që qytetarët e vendit e mbështesin policinë e Kosovës dhe do të jenë pranë SHPK-së, sepse në këto rrethana dhe kushte Kosovës nuk i duhet pasiguria dhe trazirat. E kuptoj se zvarritja e zgjedhjes së statusit të Kosovës krijon frustrim te qytetarët, por besoj që qytetarët dhe institucionet e vendit bashkë me policinë e Kosovës do të menaxhojnë situatën dhe çështjen e sig-

urisë së vendit ta mbajnë në nivel të duhur. Sigurisht që në këtë fushë ne kemi përkrahjen e angazhimit të përbashkët dhe koordinimin me policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in."- u shpreh Gjeneral nënkolonel Ahmeti.

Edhe ekspert të ndryshëm për çështje të sigurisë janë të mendimit se statusi i pazgjidhur i Kosovës është një sfidë e madhe për sigurinë e Kosovës. Dr. Matheë Rhodes (nga Qendra për Studime të Sigurisë "George Marshall") në një konferencë të mbajtur në Prishtinë ndan mendimin e njëjtë:

"Mendoj se statusi i pazgjidhur i Kosovës ndikon edhe në vendet e rajonit dhe mendoj se kjo është edhe një arsye që të gjitha vendet e rajonit të qartësojnë se çfarë statusi duhet të ketë Kosova." – theksoi profesori për studime të sigurisë në Qendrën Marshall dr. Rhodes.

Në anën tjetër të gjitha stacionet kanë një pjesë të pajisjeve të cilat edhe mund të shfrytëzohen për kontrollimin e masës nëse vjen deri te prishja e rendit dhe qetësisë publike në masë të gjerë.

Tani, në këto momente të rëndësishme për Kosovën dhe të ardhmen e saj, duhet të vazhdohet me angazhimet dhe detyrat që i shtrohen policisë. Me një profesionalizëm, dedikim dhe përkushtim ti tejkalojmë sfidat që kemi dhe ato që do të na dalin përpara në këtë fazë sa të rëndësishme aq edhe të ndjeshme për Kosovën.

ROLI I SHPK-SË NË PARANDALIMIN DHE LUFTIMIN E KRIMIT TË ORGANIZUAR NË KOSOVË



Situata e përgjithshme e sigurisë në Kosovë për momentin është e qetë edhe përkundër faktit që Kosova gjendet në një fazë shumë të rëndësishme dhe të ndjeshme kur pritet të definohet Statusi Final i Kosovës. SHPK-ja në bashkëpunim me policinë e UNMIK-ut dhe KFOR-in ka marrë të gjitha masat e nevojshme që të parandalojmë çdo aktivitet i cili do të mund të ndikonte në destabilizimin e situatës

së përgjithshme të sigurisë gjatë kësaj faze shumë të ndjeshme për Kosovën. Krimi i organizuar padyshim se përbën rrezik permanent për demokracinë, rendin e së drejtës, të drejtat e njeriut si dhe progresin ekonomik e shoqëror, dukuri nga e cila edhe Kosova sikurse edhe vendet e tjera në tranzicion nuk është kursyer. Pra, edhe Kosova si edhe shtetet e tjera të Evropës Juglindore është e ndikuar

Krimi i organizuar në Kosovë si një ndër faktorët e destabilizimit të gjendjes së përgjithshme të sigurisë në Kosovë

nga këto dukuri, e në mënyrë të veçantë nga krimi i organizuar i të gjitha formave. Prandaj është e domosdoshme që të gjitha vendet në të cilat ky lloj i krimit ekziston të krijojnë një strategji unike dhe të përbashkët me qëllim të parandalimit dhe të luftimit të kësaj dukurie në mënyrë sa më të efektshme. Përveç kësaj, rrezik tjetër i veçantë nga krimi i organizuar si dukuri negative në shoqëri është aftësia e jashtëzakonshme e kryesve të tij t'i shfrytëzojnë kushtet e volitshme për infiltrimin e vet në strukturat legale shoqërore (Institucione dhe Organizata) dhe me përpikshmëri t'i adaptohet situatës shoqëro-politike dhe ekonomike, jo vetëm në nivel të vendit por edhe në atë ndërkombëtarë. Gjendjen faktike e paraqet e dhëna se megjithëse krimi i organizuar nuk shfaqet në të gjitha vendet në formën e njëjtë, grupet kriminale lehtë ia arrijnë të ndërliqhen në mes veti nga një vend në tjetrin jo vetëm në vendet fqinje por dhe në vendet e largëta ku e gjithë kjo veprimtarisë së tyre i jep karakterin ndërkombëtar dhe interkontinental. Krimi i Organizuar së bashku me terrorizmin sot paraqet rrezikun dhe kërcënimin më të madh për sigurinë jo vetëm në nivel kombëtar por edhe atë ndërkombëtar. Ky lloj i krimit para se gjithash shfrytëzon dhe keqpërdorë të arriturat e një civilizimi modern si psh: tregun global në sferën e tregtisë dhe financave, përparimin e

shkencës dhe teknologjisë e në veçanti sferën e telekomunikimit si dhe konfigurimin e gjeopolitikës së re të botës.

Shoqëria kosovare që nga periudha e pasluftës po kalon nëpër procesin e reformave pothuajse në të gjitha segmentet si një shoqëri në tranzicion. Andaj edhe situata aktuale e sigurisë paraqitet ende e brishtë dhe komplekse me rreziqe e kërcënime të ndryshme duke pasqyruar se të gjitha Institucionet në Kosovë përfshirë edhe ato të zbatimit të Ligjit janë relativisht të reja dhe ende në fazën e formimit, zhvillimit dhe profesionalizimit të tyre.

Kosova për shkak të pozitës së saj gjeografike në këtë pjesë të Evropës ka një rëndësi të veçantë dhe paraqitet si një vend tranzit lindje – perëndim, territori i saj paraqitet joshës dhe i përshtatshëm për zhvillimin e veprimtarive të ndryshme të krimit të organizuar.

Në luftën kundër krimit të organizuar është i domosdoshëm një bashkëpunim intensiv transnacional, dhe nuk mund të paramendohet të arrihet ky synim pa përkrahjen adekuate të sistemit të drejtësisë, pjesëmarrjes së mediave dhe organizatave joqeveritare. Në këtë kontekst ky problem nuk mund të shikohet në mënyrë të izoluar por është domosdoshmëri që këtë luftë ta përkrahin të gjithë.

Shqetësimi në rritje lidhur me krimin e organizuar si dhe perspektiva e pranimit të Kosovës në Institucionet ndërkombëtare janë brengë shtesë për një analizë thelbësore të shtrirjes, natyrës dhe karakteristikave të këtij fenomeni.

Krimi i Organizuar në Kosovë merr formë të ndryshme dhe përfshinë një shumëllojshmëri të aktiviteteve kriminale si: Kontrabandimi dhe Trafikimi i Drogës, Kontrabandimi dhe Trafikimi i Armëve, Kontrabandimi dhe Trafikimi i Qenieve Njerëzore, Krimet Ekonomike, Financiare dhe Korrupsioni, Vjedhja e Organizuar e veturave etj.

SHPK-ja, roli dhe sfidat e këtij subjekti në luftimin e të gjitha formave të krimit të organizuar, tani dhe në të ardhmen

SHPK-ja si organizatë e re policore në rajon që sivjen ka festuar 8 vjetorin e krijimit të vet dhe me ndihmën e bashkësisë ndërkombëtare ka arritur të krijojë

njesitë e veta të specializuara.

Në SHPK, në kuadër të Departamentit të Krimit ekzistojnë Drejtorati i Krimeve të Rënda, Drejtorati i Analizës Kriminale, Drejtorati i Forenzikës, Njësia Antiteroriste dhe Drejtorati kundër Krimit të Organizuar i cili merret me hetimin e të gjitha formave të krimit të Organizuar, Poashtu me qëllim të një pune sa më efikase të SHPK-së, edhe në nivel regjional janë themeluar sektoret e veqanta si Sektori i Hetimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore, Sektori i Hetimit të Narkotikëve si dhe Njësitë e Inteligjencës së Krimit, të cilat merren me hetimin dhe mbledhjen e informacioneve rreth këtyre rasteve në regjionet përkatëse.

SHPK gjatë këtyre viteve ka arritur rezultate të theksuara në luftën kundër krimit në përgjithësi dhe krimit të organizuar në veçanti, mirëpo duke pasqyruar se jemi një Shërbim relativisht i ri edhe më tutje është esenciale trajnimet e specializuara të stafit në të gjitha nivelet dhe falë bashkëpunimit dhe përkrahjes nga vendet e ndryshme një pjesë shumë e madhe e policëve të SHPK-së janë duke ndjekur trajnime të ndryshme të specializuara. Vlen të cekën trajnimet e ofruara nga Qendra Marshall, AER, si dhe nga shtetet e ndryshme ku rasti më i freskët është trajnimet e ofruara nga Turqia ku një numër i madh i pjesëtarëve të SHPK-së kanë kryer dhe janë duke kryer trajnime të ndryshme kryesisht Inteligjencë, Krimit të Organizuar dhe Kundër Terrorizëm.

SHPK gjatë këtyre viteve ka arritur rezultate të theksuara në konfiskimin e lëndëve narkotike dhe arrestimin e shumë personave të dyshimtë. Në bazë të shifrave të Policisë në Kosovë që nga viti 2001 deri në vitin 2006 janë konfiskuar:

248157 gram Marihuana, 125506.6 gram Heroinë, 13721.9 gram Kokainë, 1543.7 gram Hashash, 25167 gram Amfetamin, 7140.2 gram Morphin, 65446 bime Kanabisë, 97 opium.

Nga Njësiti i Hetimit të Trafikimit të Qenieve Njerëzore nga viti 2001 e deri në vitin 2006 në Kosovë janë identifikuar 426 viktima të trafikimit si dhe janë arrestuar shumë persona të dyshimtë ndërsa nga këto viktima 375 janë riatdhesuar.

Bashkëpunimi ndërinstitucional dhe rajonal

Duke pasqyruar se Krimi i Organizuar ka një dimension ndërkufitar, është pothuajse e pamundur që organet zbatuese të Ligjit të arrijnë një sukses të dëshirueshëm pa një bashkëpunim të mirë dhe qasje të përbashkët me autoritetet e vendeve tjera, prandaj SHPK-ja përmes UNMIK-ut me këtë qëllim ka patur dhe vazhdon të ketë bashkëpunim të mirë me të gjitha njësitë gjegjëse të vendeve të rajonit dhe edhe më gjerë dhe se deri më tani falë këtij bashkëpunimi janë identifikuar dhe hetuar shumë grupe kriminale dhe janë vënë para drejtësisë. Meqenëse SHPK ende nuk ka kaluar në tranzicion të plotë si dhe statusi i Kosovës është i padefinuar, ende nuk është e inkuadruar në Agjencionet e ndryshme ndërkombëtare si anëtare e rregullt në Eurpol, Interpol, SECI, etj, bashkëpunimi edhe më tutje vazhdon të bëhet përmes zyrës ndërlidhëse të UNMIK-ut me status të vëzhguesit. Kohëve të fundit me iniciativë të ndryshme të Këshillit të Evropës është shtuar bashkëpunimi mes Drejtorateve Kundër Krimit të Organizuar të vendeve të ndryshme të rajonit që ka rezultuar edhe me një shkëmbim shumë më të mirë të informacioneve si dhe përvojave.

Sfidat e SHPK-së në ballafaqim me Krimin e Organizuar:

Shërbimi Policor i Kosovës ka para vetës vështirësi dhe sfida në fushën e luftimit të krimit të organizuar, disa nga këto sfida janë:

1. Statusi i Padefinuar i Kosovës (statusi i kufijve "ndërkombëtar dhe administrativ"),
2. Mosekzistimi i strategjisë nacionale për siguri,
3. Mosekzistimi i Shërbimit të Inteligjencës në nivel Nacional,
4. Mungesa e infrastrukturës së nevojshme ligjore (Ligji për mbrojtjen e dëshimtarëve etj),
5. Mungesa e autonomisë së veprimit (fondet e veçanta, pajisjet, mirëmbajtja, procedurat aktuale të prokurimit etj).

Sektori i sfidat dhe

Trajnimi për përdorimin dhe mirëmbajtjen e armës bën pjesë në trajnimet themelore të çdo policie në botë. Shumë shkrime mund të përgatiten në këtë drejtim por kësaj radhe jemi fokusuar në një historik të shkurtër të këtij sektori duke përshkruar edhe disa nga sfidat e Sektorit të armëve të zjarrit. Për të gjitha këto informata na ndihmoi rreshter Kadrush Koliqi i cili punon si udhëheqës i këtij sektori.

armëve të zjarrit rezultatet

Z.Koliqi a mund të na tregoni kur filloi punën sektori i Armëve të Zjarrit dhe cili është funksioni i tij?

Rreshter KOLIQI: Sektori i Armëve të Zjarrit filloi punën në shtator të vitit 1999 me themelimin e Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës. Atë kohë ky sektor kishte 26 instruktorë ndërkombëtarë (OSBE) dhe 12 përkthyes - staf lokal. Funksioni i këtij sektori është që t'i trajnojë pjesëmarrësit në përdorimin e armëve, t'i njoftojë për rreziqet dhe mirëmbajtjen e tyre, sipas ligjeve dhe rregulloreve që janë në fuqi.

Trajnimet për armë mbahen nga instruktorët vendorë. Na tregoni diçka më shumë rreth funksionimit të këtij sektori nën mbikëqyrjen e instruktorëve të SHPK-së? **Rreshter KOLIQI:** Në vitin 2001 filluan të hapen vende të lira pune për pjesëtarët e SHPK-së në ish- SHSHPK. Në atë kohë kërkoheshin instruktorë në lëmi të ndryshme. Kursi i parë për instruktorë të armëve të zjarrit është mbajtur në fund të vitit 2001 dhe fillimisht në këtë sektor u pranuan 10 instruktorë nga regjione të ndryshme. Me kalimin e kohës në bazë të kërkesave si ndihmesë për kryerjen e punëve në mënyrë sa më profesionale, në këtë sektor u punësuan edhe 5 instruktorë të tjerë. Këta instruktorë duke u bazuar në plan-programin mësimor, bëjnë trajnimin, ri-trajnimin dhe vlerësimin e pjesëmarrësve në trajnime, sipas standardeve të parapara nga Qendra.

Kush ju ndihmoi në furnizimin me armë dhe cilat lloje të armëve shfrytëzohen për trajnim?

Rreshter KOLIQI: Me fillimin e punës së ish Shkollës së Shërbimit Policor të Kosovës, OSBE-ja solli 129 pistoleta Glock-19 dhe një sasi të mjaftueshme të municionit 9 mm, për trajnimin e kadetëve të

SHPK-së. Këto armë janë ende pronë e OSBE-së, mirëpo pritet që shumë shpejt t'i dhurohen Qendrës si donacion nga ana e tyre. Në vitin 2001, UN-i sjellë në SHSHPK 15 pushkë të gjata AK-47 të konfiskuara, për trajnimin e policëve të SHPK-së, të cilat edhe sot shfrytëzohen për trajnime. Këto armë ruhen në depon e armatimit e cila gjendet përbrenda Qendrës për Siguri Publike.

Përveç pjesëtarëve të SHPK-së, trajnimet për armë i kryejnë edhe pjesëtarët civilë të kompanive të ndryshme. Cila është arsyeja e trajnimit të tyre?

Rreshter KOLIQI: Përveç pjesëtarëve të SHPK-së, në trajnim kemi individë nga organizata të ndryshme si nga Shërbimi Korrektues i Kosovës, Shërbimi Doganor i UNMIK-ut, Ministria e Shërbimeve Emergjente, PTK-ja, Sigurimi i MPB-së dhe i Ministrive të tjera, Sigurimi i Presidentit të Kosovës, etj. Do të thotë të gjithë ata persona që posedojnë lejen për armëmbajtje janë të obliguar t'i përfundojnë trajnimet për përdorimin e armëve. Ata duhet të kenë njohuri të mjaftueshme për mirëmbajtjen dhe përdorimin e armëve të zjarrit, në të kundërtën nuk mund të pajisen me to.

Si shkon procedura e mësimi të qitjes me armë? Sa është kohëzgjatja e trajnimit për fillestar?

Rreshter KOLIQI: Trajnimi themelor për kadetët e SHPK-së është përdorimi i pistoletës GLOCK-19 i cili zgjatë 11 ditë apo 85 orë mësimi të pjesës teorike dhe praktike. Ky trajnim përmban këto udhëzime: Siguria me armë zjarri, manipulimi-përdorimi, kujdesi dhe mirëmbajtja e armës. Pas përfundimit të pjesës teorike në klasë pjesëmarrësit marrin udhëzime në sis-

temin kompjuterik të trajnimit me armë zjarri i njohur me shkurtesën FATS (Simulator Trajnimi me Armë Zjarri). Këtu bëhen ushtrime të gjuajtjes me armë zjarri në caqe statike në distanca të ndryshme. Me përfundimin e pjesës teorike dhe ushtrimeve me armë të thata (pa municion), duke përfshirë edhe sistemin për gjuajtje FATS, studenti do të aftësohet për gjuajtje në poligon të gjuajtjes me municion luftarak nën kontrollin e instruktorëve. Siguria në poligon është një prej faktorëve kyç krahas teknikave të caktuara për gjuajtje me armë zjarri.



Cili është funksioni i FATS-it?

Rreshter KOLIQI: FATS- "Simulator Trajtimi me Armë Zjarri". Kjo pajisje elektronike është shumë e avancuar dhe shumë e përdorur për trajnimin e forcave policore dhe ushtarake në shumë vende të ndryshme të botës. Kjo pajisje është sjell në Qendër në vitin 1999 nga OSBE-ja dhe akoma i përket kësaj organizate, po shumë shpejt edhe kjo pajisje pritet të jetë një donacion për Qendrën.

Në këtë pajisje janë të instaluar dy armë GLOCK-19 të cilat veprojnë përmes gazit CO2. Kjo pajisje e lehtëson shumë punën e instruktorëve sepse ka mundësi që t'i analizojnë gjuajtjet e bëra. Ka mundësi që me këtë pajisje të bëhet trajnimi në caqet standarde statike të SHPK-së dhe atë në distanca të ndryshme dhe me skenarë të ndryshëm të improvizuar ku ushtrohet përdorimi i forcës vdekjeprurëse - armës

së zjarrit. Me këtë pajisje janë trajnuar dhe trajnohen të gjithë kadetët e SHPK-së, po ashtu përdoret edhe për trajnimet e personave civilë nga organizata të ndryshme.

Fillimisht, Sektori për Armë Zjarri ka pasur në shfrytëzim vetëm dy poligone. Sa ka qenë e vështirë që të trajnohen një numër i madh studentësh duke pasur parasysh një numër aq të vogël poligonesh?

Rreshter KOLIQI: Që nga fillimi ne kemi pasur shumë trajnime për armë zjarri sepse trajnimi i SHPK-se atë kohe ishte emergjent dhe shumë herë ka ndodh që ne kemi pasur nga dy gjenerata në të njëjtën kohë në trajnim, e krahas kësaj njëkohësisht edhe ricertifikimin e oficerëve të SHPK-së me armë zjarri, dhe ne kishim në shfrytëzim vetëm dy poligone. Në vitet e fundit kemi pasur shumë trajnime tjera për armë zjarri sepse ne filluam

edhe me trajnimet e avancuara për SHPK-në si trajnimin me armë të gjatë MP-5 dhe AK-47. Shkurt, mund të them se problemet kanë qenë të shumta por falë vullnetit të instruktorëve për punë i kemi përballuar dhe tejkaluar ato.

Ky sektor është përgjegjës edhe për mbajtjen e trajnimit të rikualifikimit. Çdo pjesëtar i SHPK-së është i obliguar t'i nënshtrohet trajnimit të ricertifikimit. A është mbajtur ky trajnim çdo vit?

Rreshter KOLIQI: Ky trajnim gjithnjë është mbajtur por me disa vështirësi sepse poligoni për gjuajtje ka qenë shumë i ngarkuar me trajnimin e kadetëve të SHPK-së. Deri në fillim të këtij viti në shërbim kemi pasur dy sektorë të armëve të zjarrit: një në SHSHPK-ë dhe një në Departamentin e Trajnimit në Prishtinë.





Ky i fundit është marrë me rikualifikimin e policëve me armë zjarri, ndërsa ne në Qendër vetëm me trajnimin themelor. Në fillim të këtij viti 2007 Sektori i armëve të zjarrit nga Dep. i Prishtinës është transferuar në Qendrën për Siguri Publike ku për momentin të gjithë së bashku merremi me trajnimin themelor, trajnime të avancuara dhe Rikualifikimin e policëve me armë zjarri. Numri i policëve në teren gjithnjë ka qenë më i madh sesa është mundur të mbahet trajnimi për rikualifikimin e tyre. Kjo ka ndodhur për arsye se ne kemi pasur vetëm një poligon për gjua-jte në SHSHPK i cili është përdorur për trajnim të kadetëve dhe Rikualifikimin e policëve, kështu që ishte e pamundur të përfshihen të gjithë policët në teren. Kohëve të fundit jemi duke punuar dhe pothuajse kemi përfunduar projektin që secili rajon të ketë Instruktorët dhe Qendrën për trajnim duke përfshirë këtu edhe poligonet për gjua-jtje. Në bazë të këtij projekti do të përfshihen të gjithë policët në trajnim për një kohë shumë më të shkurtër ashtu si është e paraparë sipas rregullores së shërbimit.

Cilat janë ndryshimet që ka pësuar ky sektor që nga fillimi i punës e gjer në vitin 2007?

Rreshter KOLIQI: Ndryshime janë të shumta, duke filluar nga trajnimi për kadetët e SHPK-së që ishte 8 javë dhe për këtë ne kishim

vetëm 5 ditë ose 40 orë për armë zjarri. Ky trajnim mbahej në gjuhën angleze ku shpenzohej shumë kohë në përkthim. Tani ky trajnim zgjat 20 javë dhe ne për sektorin e armëve të zjarrit kemi 11 ditë ose 85 orë trajnimi që është një kohë e mjaftueshme për trajnim themelor për pistoletë.

Meqenëse tani nuk ka kadetë në trajnimin bazik, çfarë trajnimesh jeni duke mbajtur për momentin?

Rreshter KOLIQI: Jemi duke punuar në plan-programë mësimore për të gjitha tra-

jnimet për armët e zjarrit dhe duke punuar në projektin e poligoneve nëpër regjione. Krahas kësaj jemi duke bërë edhe rifreskimin e kursit për strukturën menaxhuese të shërbimit - trajnim ky që mbahet me pajisjen FATS. Dhe së fundi katër instruktorë të armëve të zjarrit janë të caktuar në komisionin për shqyrtimin e rasteve të përdorimit të armës së zjarrit.

Intervistoi: Njomza Krasniqi
Shërbimi për Informim
i QKSPEZH



NJERËZIT SIKUR JU NË SHËRBIMIN TUAJ

**Institucionet e sigurisë në Kosovë
komunikojnë me publikun**





Në të gjitha rajonet e Kosovës, Shërbimi Policor i Kosovës dhe Shërbimi i Zjarrfikësve dhe Shpëtimit organizuan 'Ditë të Hapur' ku qytetarët u takuan drejtpërdrejt me policët, zjarrfikësit dhe zyrtarët e doganave dhe i panë nga afër duke i demonstruar shkathtësitë e tyre.

"Qëllimi i Ditës së Hapur është t'i afroji zyrtarët e policisë dhe doganave, si dhe zjarrfikësit, më pranë qytetarëve të Kosovës," tha Zv.Komisari i SHPK-së Sheremet Ahmeti. Ai kishte ardhur personalisht që të shikonte organizimin e "Ditës së Hapur" në Prishtinë në sallën 1 Tetori:

"koordinimi dhe bashkëpunimi i institucioneve që janë përgjegjëse për sigurinë gjithmonë sjell rezultate të mira. Suksesi ynë varet nga besimi dhe bashkëpunimi me qytetarët" –theksoi Gjeneral nënkolonel Ahmeti.

Këto organizime ishin pjesë e fushatës së përkrahur nga OSBE-ja për të promovuar punën e Shërbimit Policor të Kosovës, Zjarrfikësve dhe Shërbimit Doganor me moton: "Njerëzit sikur ju –

në shërbimin tuaj!"

Këtij organizimi i parapriu një defilim i njësiteve të ndryshme të SHPK-së, Shërbimit të Zjarrfikësve dhe Shpëtimit si dhe Shërbimit Doganor në rrugët e Prishtinës, i cili filloi në ora 10:00 nga ndërtesa e Komandës Rajonale të Policisë nëpër rrugën Luan Haradinaj, kah Pallati i Rinisë, në rrugën Nëna Terezë dhe Eqrem Çabej e deri te Salla e Sporteve '1 Tetori'.

Shumë nxënës të shkollave fillore të Prishtinës kishin shfaqur interesim për të shikuar demonstrimet e këtyre tri institucioneve dhe kishin mbushur pjesën para sallës "1 Tetori" në Prishtinë.

Fëmijët shikonin me vëmendje "arrestimet" spektakulare të "personave të dyshimtë" e sidomos pjesën kur edhe qeni policor ishte i kyçur në këtë aksion. Këto demonstrime nxitën duartrokitje të njëpasnjëshme të nxënësve që përcillnin këtë ngjarje me buzëqeshje në fytyrat e tyre.

Pas demonstrimeve u bë një radhë e gjatë e fëmijëve që dëshironin të mer-



rnin foto mbi motoçikletën e policisë ose edhe me pajisje policore në duart e tyre. Disa shfaqnin interesim për punën e njësitit K-9 e disa të tjerë përshëndetnin me kapele të policisë që i mbanin me krenari në kokat e tyre.

"OSBE-ja ka mbështetur këto institucione sepse besojmë se kanë një të ardhme të ndritur në Kosovë. Ne duam që t'i përmirësojmë raportet në mes të këtyre shërbimeve dhe publikut të gjerë, në mënyrë që të mund ta ndihmojnë njëri-tjetrin më mirë në të ardhmen," tha Tim Guldemann, Ambasadori i OSBE-së në Kosovë.

Dita e Hapur ju dedikua familjeve, me theks të veçantë nxënësve dhe të rinjve me prindërit ose arsimtarët e tyre.

Të gjithë nxënësit pjesëmarrës në ngjarje morën shpërblime dhe dhurata të vogla nga policia dhe zjarrfikësit.



DSSHHPK-ja festoi 6 vjetorin e themelimit



ATY KU REZULTATET E PUNËS NUK MUNGOJNË

Dinamika e jetës në Kosovë, ka bërë që pjesëtarët e SHPK-së energjinë më të madhe ta shfrytëzojnë në kryerjen e detyrave të tyre të përditshme me gjithë përgjegjësinë në këtë fazë të rëndësishme për Kosovën. Kjo ka bërë që pjesëtarët e SHPK-së, të kenë fare pak mundësi për të gjetur kohë për t'u kënaqur me aktivitete të lira, qofshin ato aktivitete sportive apo ahengje të ndryshme.

Mirëpo, për pjesëtarët e DSSHHPK-së (Divizioni i Sigurimit tash e gjashtë (6) vite, është bërë rregull që njëherë në vit të organizohet e ashtuquajtura Përvjetori i DSSHHPK-së. Dhe pikërisht më 9 nëntor, nga pjesëtarët e DSSHHPK-së, u organizua një mbrëmje shoqërore ku u kremtua përvjetori i gjashtë (6) i themelimit të DSSHHPK-së, e ku morën pjesë rreth 250 pjesëtarë

dhe mysafirë të ftuar.

"Është plotësisht i arsyeshëm festimi në këtë mbrëmje duke pasur parasysh se DSSHHPK-ja për 6 vite me radhë ka arritur rezultate të mëdha. Puna juaj ka bërë që ne të krenohemi me këto rezultate" - tha ndër të tjera Komandanti i DSSHHPK-së, major Muharrem Çunaku.

Mirëpo përkundër sukseseve, DSSHHPK-ja u ballafaqua edhe me probleme të caktuara, të cilat jo rrallëherë po e vënë në sprovë funksionimin e suksesshëm të kësaj njësie.

Dihet mirëfilli se, O/S-të kanë një statut i cili nuk u jep kompetencë të veprimit sikur që kanë policët e SHPK-së. Po ashtu, këta O/S nuk janë të pajisur me armë dhe pajisje tjera shtesë, gjë që ka efekt shumë negativ për vetë sigurinë e O/S-ve dhe objekteve që i sigurojnë.

DSSHHPK-ja po ballafaqohet edhe me mungesë të madhe të O/S-ve, krahasuar me numër të madh të objekteve që u ofrojnë siguri. Por, përkundër të gjitha këtyre që u cekën më lart, mund të themi se ekziston vullnet dhe gatishmëri i të gjithë pjesëtarëve të DSSHHPK-së për një organizim dhe punë profesionale të nivelit edhe më të lartë. Për arritjen e objektivave të DSSHHPK-së, është e nevojshme edhe ndihma dhe përkrahja e të tjerëve, e posaçërisht e nivelit më të lartë të SHPK-së.

Disa prej problemeve me të cilat ballafaqohen ky Divizion i ceku në fjalimin e tij Gjeneral major Behar Selimi. Ai në fjalën e tij, falënderoi gjithë pjesëtarët e DSSHHPK-së për punën e madhe dhe profesionale që janë duke bërë. Ai potencoi edhe çështjen e statutit të O/S-ve për të cilën u zotua se së shpejti do të ketë progres edhe në këtë drejtim. Kjo mbrëmje u përmbyll me gatishmërinë e të gjithëve për të kontribuar edhe më shumë në të ardhmen dhe me shpresën se do të punohet më tepër rreth pajisjes së tyre me armë dhe avancimit të statutit të tyre.

Nga rreshter Skënder Xhema

Solidarizimi është çelësi kryesor për t'i tejkaluar sfidat

SSHPK-ja merr pjesë në Kongresin e Konfederatave të Sindikatave të Policisë së Evropës - Eurocop

Konfederata e Sindikatave të Policisë së Evropës (Eurocop) me datë 5, 6 dhe 7 nëntor mbajti Kongresin e dytë të rregullt në Bruksel, ku të pranishëm ishin 26 shtete dhe 33 unione të sindikatave të pavarura të policisë, përfshirë shtetet të cilat janë anëtare të BE-së, si dhe Sindikata e Shërbimit Policor të Kosovës.

Mysafirë të pranishëm ishin edhe kryetarja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, znj. Valbona Kamberi, z.Dale Kinnear nga Sindikata e Policisë së Kanadës, z.Heinz Wiederkehr përfaqësues i Kompanisë së sigurimeve për Policinë Evropiane **"Zurich Direct & Partner"** nga Zvicra, që ka selinë në disa shtete të Evropës si në Angli, Spanjë, pastaj z.Olivier Libois nga Policia federale e Belgjikës, Maria Helena ANDRE nga Konfederata e Sindikatave të Pavarura të Evropës (ETUC), z. Franco Frattini, zëvendës-presidenti i Komisionit Evropian, Jose Manageiro dhe Cesar Nogueira nga Shoqata e profesionistëve të gardës në Portugali, si dhe personeli i cili ka punuar me vite dhe ka kontribuar në Eurocop.

Kongresin e hapi z. Heinz Kiefer, president i konfederatës, i cili gjithashtu fitoi edhe një mandat si president i kësaj konfederate.

Ai përshëndeti të gjithë të pranishmit, ndërkaq mysafirëve nga Sindikata e SHPK-së u uroi anëtarësim sa më të shpejtë në familjen e policisë në Eurocop.

Pjesëmarrësit në Kongres kanë votuar edhe për zgjedhjen e presidentit dhe 5 anëtarëve të Komitetit ekzekutiv. Të gjitha propozimet kaluan me votime nga të gjitha shtetet pjesëmarrëse, ku të drejtë vote kishin 70 delegatë.



Heinz Kiefer
President i Eurocop-it

Kryetarja e Sindikatës së Policisë së Kosovës, znj.Valbona Kamberi, në emër të Sindikatës, ka nderuar me një mirënjohje kryetarin e EuroCop, z.Heinz.

"Derisa policia e Kosovës ballafaqohet me probleme elementare jetike, me kushte shumë të vështira të punës dhe gjendje social-ekonomike pa ligj, pa rrezikshmëri, pa sigurim shëndetësor, pa sistematizim të vendeve të punës, pa shujte etj; - policia evropiane mendon ndryshe se si ta luftojë krimin dhe si ta luftojë terrorizmin dhe si të bashkëpunohet nga ky drejtim, në mënyrë që të sigurohen policët evropianë nga kjo dukuri, e cila tanimë është fenomen në Evropë", ka thënë në fjalën e tij zëvendës presidenti i Komisionit evropian, Franco Frattini, në ditën e tretë të Kongresit.

Frattini ka folur edhe për bashkëpunimin ndërmjet Konfederatës së policisë Evropiane dhe Komisionit Evropian, i cili tha se për ta

luftuar krimin duhet një bashkëpunim ndërmjet shteteve anëtare të BE.

"Përfaqësimi i 33 organizatave policore pranë Eurocop-it e bënë këtë një organizatë të suksesshme. Ju punoni në baza ditore dhe ju i kuptoni më mirë problemet operacionale dhe mund të na ndihmoni për implementimin e planeve tona strategjike në aktivitetet operacionale. Plani im është që të jemi sa me afër me sindikatat policore. Solidarizimi është çelës dhe ne duhet të bashkëpunojmë për t'u dalë ballë sfidave, sepse është mënyra e vetme për ta luftuar terrorizmin. Asnjë shtet nuk mund të merr vendime në vete" tha ndër të tjera zëvendës presidenti i Komisionit Evropian.

Gjatë qëndrimit në Bruskel, znj.Kamberi është takuar me zëvendës presidentin e Komisionit evropian, Franco Frattini, të cilit shkurtimisht i prezantoi aktivitetet e sindikatës së SHPK-se dhe problemet me të cilat po ballafaqohet policia e Kosovës.

Ai tha se i kemi parasysh problemet me të cilat po kalon Kosova dhe problem të cilat i ka policia e Kosovës, ndërkaq premtoi se në një të ardhme të shpejtë policia e Kosovës do të jetë e barabartë me të gjitha organizatat tjetra policore në Evropë dhe se shumë shpejtë këto probleme do të prezantohen edhe në Këshillin e Sigurimit.

Kryetarja e Sindikatës të SHPK-së, znj.Kamberi, ka pasur takim edhe me përfaqësues të sindikatave të ndryshme të Evropës si Sllovenisë, Italisë, Gjermanisë, Greqisë, Spanjës, Finlandës, Danimarkës, Suedisë, Norvegjisë etj.

NAIM MALAZEZI

KAMPION I ATLETIKËS KOSOVARE

Naimi është pjesëtar i DSSHPK-së. Krahas dedikimit të tij në shërbim, ai ka edhe një jetë aktive në sport në përgjithësi e në veçanti në atletikë.

Duke qenë Kampion i Kosovës në Atletikë ai ishte edhe atleti i parë kosovar që përfaqësoi Kosovën në Kampionatin Ballkanik të Atletikës për Veteran që u mbajt me 7 dhe 8 tetor të këtij viti në Plovdiv të Bullgarisë dhe ku arriti suksese të jashtëzakonshëm duke fituar medaljen e artë në 100m dhe atë të argjendtë në 200m.

“Me pjesëmarrjen time dhe me suksesin e dëshmuar i befasova këndshëm të gjithë, kjo ishte një surprizë mbresëlënëse madje edhe për mua. Shpresoj se e kam arsyetuar besimin” – theksoi Malazezi në lidhje me sukseset e arritura në Plovdiv të Bullgarisë.

Ai më tej shpjegoi për Mbrojtësin se me sport ka filluar të merret qysh nga viti 1975 ,së pari me gjashtë garëshe, pastaj me gjimnastikë dhe nga viti 1982 me atletikë. Që nga viti 1982 deri me 2002 ishte shumë aktiv në atletikë duke marrë pjesë në të gjitha dhe në të gjitha konkurrencat në Kosovë. Ai ka shënuar rezultate të mira në 60,100,200 ,300 si edhe në shumë gara në 400 metra duke shënuar edhe rekorde si :në 60 m - 6.95 sek. në vitin 2000; 100 m - 10.5 s viti 1985; 200 m - 21.20 s viti 1996; 300 m - 35.60 s viti 1983, rekorde këto ende të pathyera, dhe në 400 m - 49.0 s - rezultati më i mirë personal. Naimi ishte i suksesshëm edhe jashtë Kosovës dhe ka korrur fitore të shumta duke u shpallur fitues në konkurrenca të ndryshme si :nën-kampion në kategorinë e Juniorëve

për ish-Jugosllavinë në 100m në vitin 1983, 4 vite radhazi fitues i Kupës “Vëllazërim Bashkimi” në 100 dhe 400m në vitet 1986,1987,1988,1989,3 vite radhazi fitues i Mitingut të Shkupit në 100 dhe 400m,në vitet 1987,1988,1989, fitues në Kampionin e Turqisë në 200m, fitues i Mitingut Ndërkombëtar “Partizanët ” në 200m në vitin 1985, Kampion i Serbisë në 100 m në vitin 1985, fitues i Kupës së Shqipërisë në 200m në vitin 1996.

Pas vitit 2002 ,për disa vite me radhë Naim Malazezi renditet në vendin e parë,të dytë dhe të tretë në garat për Kupë ,Kampionate apo edhe Mitingje të ndryshme në Kosovë.

Viti 2007 është viti me i begatshëm për atletin kosovar. Ne këtë vit ka arritur këto suksese: fitues i Kupës së Kosovës në 100 dhe 200m (Senior),fitues në shumë mitingje në 100m, nën-kampion i Kosovës në 100m, fitues në konkurrencën e veteranëve mbi 40 vjeç, kampion i Shqipërisë në 60m, kampion Ballkanik në 100m dhe nën-kampion Ballkanik në 200m.

I pyetur për planet e tij në të ardhmen ai shprehet se do të ishte i kënaqur që ta përfaqësonte me sukses Kosovën në kampionatet e ardhshme ndërkombëtare:

“Shpresoj që do ta përfaqësoj Kosovën në Kampionatin Botëror që do të mbahet në Francë në Mars të 2008-s,pastaj në Kampionatin Evropian në Lubjanë në Korrik 2008. Synimet e mia janë që ta përfaqësoj edhe SHPK-në në garat e Policëve Evropian dhe Botëror të cilat do të mbahen në një të ardhme të afërt”- theksoi i pari i atletikës kosovare, Naim Malazezi.



Për hetimet
rajonale të
rajonit të Pejës
dhe të arriturat
e tyre flet shefi i
hetimeve -
toger
Muhamet Lama

REZULTATET E ARRITURA NGRITIN IMAZHIN E SHPK-së

Në vazhden e luftës kundër krimit, Njësitit i Hetimeve Rajonale ka ndërmarrë hapa për hetimin dhe zbulimin e kryesve të veprave të renda penale, gjë që tregon edhe rezultatet e arritura nga kjo njësi. Ky njësit është i organizuar në tri segmente si : Hetimet në veprat ndaj personave, hetimet në veprat kundër pronës dhe hetimet e specializuara.

Shefi i Hetimeve Rajonale, Toger Muhamet Lama, flet me krenari për rezultatet e arritura si dhe angazhimin e këtyre njësive në luftën e krimit për secilin segment veç e veç. Toger Lama nuk e fsheh kënaqësinë kur prezanton rezultatet për periudhën 9 mujore të këtij viti, ku kuota e përqindjes në zbulimin e rasteve mbi 82% të të gjitha rasteve të cilat i heton kjo njësi.

Në luftimin e dukurive të shprehura së fundit në rajonin e Pejës në kuadër të Njësitit Rajonal të Hetimeve vlen të veçohet ekipi për hetimin e rasteve të grabitjeve të armatosura.

“Krimet Ekonomike, dëmtimi i buxhetit të konsoliduar të Kosovës si dhe keqpërdorimi i detyrave zyrtare kanë shtyrë stafin udhëheqës së bashku me hetuesit të ndërmarrin masa konkrete për luftimin e këtyre dukurive. Si rrjedhojë e kësaj, në kuadër të Njësitit të Krimeve Ekonomike është formuar

njësitit Anti-korrupsion dhe rezultatet e tyre janë evidente”- shprehet togeri Lama.

Ai vazhdon duke folur më tej për sfidat që ata ballafaqohen në rastet me mjete shpërthyes pasi që hetimet e këtyre rasteve në masë të madhe varen nga ekspertiza e bërë nga Njësitet e Specializuara të KFOR-it.

“Hetimet e tilla janë komplekse dhe kërkojnë kohë dhe angazhimin maksimal por përkundër kësaj kohet e fundit është vërejtur progres edhe në këtë drejtim”- pohon Lama.

Në pyetjen t se ku fshihet sekreti i menaxhimit te suksesshëm, ai potencoi se nuk ka ndonjë sekret por puna ekipore dhe angazhimi i secilit pjesëtar të njësitit duke mos anashkaluar përkrahjen e Stafit Komandues në të gjitha kërkesat e tyre në përmbushjen e misionit kane dhënë rezultatet e duhura.

Gjate bisedës se zhvilluar me shefin e hetimeve nuk u anashkalua as biseda rreth bindjes së krijuar në opinion se Peja është e njohur si vend “problematik” .

Toger Lama këtë konstatim e mohon me ngulm duke prezantuar rastet e vrasjeve për këtë periudhë kohore (9 mujorin 2007) ku gjate kësaj periudhe thekson se janë evidentuar 10 raste te


vrasjeve dhe 90% e këtyre rasteve janë të ndriçuara dhe se kryesit e këtyre veprave i janë dorëzuar organeve të drejtësisë.

Ai na tregoi edhe për përkushtimin e Njësitit për hetimin e veprave të mëhershme për të cilat thotë se anjëherë nuk do të mbesin në sirtarë:

“Hetuesit janë duke u marrë në mënyre aktive dhe duke punuar për ndriçimin e tyre, vlen të ceket se dy raste të vrasjeve të viteve 1999-2000, janë proceduar në organet e drejtësisë me kryes të njohur” – shprehet Lama.

Ai thekson se rezultatet e arritura kanë rritur edhe imazhin e SHPK-së tek qytetarët, gjë që tregon rritja e besueshmërisë së tyre dhe bashkëpunimi në rritje. Ai pjesën më të madhe të suksesit ua adreson qytetarëve të cilët me dhënien e informatave të rëndësishme i kanë ndihmuar hetuesit për kapjen e kryerësve të veprave penale.

“Rezultatet e arritura janë motiv shtesë që të vazhdohet me angazhim edhe më të madh në zbatimin e detyrave dhe përgjegjësi tona në zbulimin e autorëve të veprave të ndryshme penale dhe vënien e tyre para drejtësisë” – theksoi në fund të intervistës shefi i hetimeve në rajonin e Pejës – togeri Muhamet Lama.



ZGJEDHJET 2007



Më 17 nëntor, në tërë Kosovën është zhvilluar procesi zgjedhor për tri palë zgjedhje. Mbi 7000 oficerë të SHPK-së ishin në detyrë për të ofruar siguri për këtë proces të rëndësishëm zgjedhor në Kosovë. Për ditën e zgjedhjeve ishte hartuar plani operativ në nivel të Shtabit

Kryesor të SHPK-së, si dhe planet me specifika të veçanta në nivele të rajoneve policore, që i mbuluan të gjitha vendbanimet.

Ditën e votimit, orari i pjesëtarëve të SHPK-së ishte zgjatuar në 12 orë, ndërsa janë anuluar të gjitha pushimet tjera,

përveç pushimit mjekësor SHPK-ja ofroi siguri edhe gjatë zgjedhjeve komunale në raundin e dytë.

Fotot lartë tregojnë pamje nga zgjedhjet e 17 nëntorit 2007.

1



Në bazë të një agjende të përbashkët, Kryeprokurori Hilmi Zhitia së bashku me prokurorin Besim Kelmendi nga Prokuroria Speciale u takuan me eprorë të SHPK-së ku u diskutua për çështje me interes të përbashkët si dhe për hapat e mëtutjeshëm për ngritjen e nivelit të bashkëpunimit të këtyre dy agjencive të zbatimit të ligjit në Kosovë.

2



Në foto shihet Gjenral major Reshat Maliqi duke ju adresuar mediave dhe qytetarëve me rastin e hapjes së nënstacionit policor në Han të Elezit. SHPK-ja ka gjithsejtë 35 stacione policore dhe 20 nënstacione, ndërsa Hani i Elezit ishte nënstacioni i 21-të. Ky është nënstacioni i katërt që u përruaa këtë vit.

3



Vetëm me inforata zyrtare, të shpejta dhe të qarta mund të luftohen thashethëmet të cilat mund të ndikojnë në gjendjen e sigurisë së përgjithshme. Në foto shihen zëdhënës të policisë, Qeverisë, MPB-së, UNMIK-ut dhe të institucioneve tjera duke diskutuar së bashku për një menaxhim sa më të mirë të informatave dhe një bashkëpunim edhe më të mirë në këtë kohë të rëndësishme për Kosovën.

4



Në foto shihet Kollan Bhattacharya duke pranuar një letër falënderimi nga Zv.Komisari i SHPK-së Ahmeti. Z. Bhattacharya këtë mirënjohje e mori për kontributin e dhënë në përkrahjen e SHPK-së gjatë misionit të tij në Kosovë si staf i Komisarit të policisë – z.Richard Monk.

5



Në këtë foto shihet protesta e organizuar nga USSH-ja – Unioni i Studentëve Shqiptar të mbajtur më 10 dhjetor 2007 në Prishtinë. Kjo ngjarje ishte e përcjellur nga shumë media vendore dhe sidomos ndërkombëtare dhe nuk u raportua për ndonjë incident.

6



Fotoja tregon protestën e aktivistëve të lëvizjes Vetëvendosja me rastin e vizitës së Treshes së Grupit të Kontaktit në Prishtinë, para dorëzimit të raportit të tyre në Këshillin e Sigurimit të OKB-së për mbarëvajtjen e bisedimeve shtesë për statusin final të Kosovës.

7



Oficerët e SHPK-së të mbështetur me një intervenim të shpejtë edhe nga Njësia Mbështetëse Operative e Mitrovicës arritën që t'i konfiskojnë 13 kg. substancë narkotike me dyshim se janë heroinë, me ç'rast arrestuan edhe gjashtë persona, katër nga të cilët janë shtetas të Republikës së Shqipërisë dhe dy banorë të Kosovës. Në foto shihet substanca narkotike e konfiskuar dhe dëshmi tjera materiale.

8



Në foto shihet droga e zbuluar nga Sektori Qendror për Hetime të Narkotikëve. Në një operacion në lagjen "Ulpiana" në Prishtinë, në fshatin Bardhosh si dhe në qytetin e Podujevës është gjetur një sasi prej mbi 1.5 kilogram substancë e dyshuar të jetë heroinë si dhe janë zbuluar edhe dëshmi të tjera materiale.

Njerëzit sikur ju në shërbimin tuaj

